



Departamenti i Prokurimit

Prishtinë: datë, 27.01.2020

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **kërkesës për ri-shqyrtim** të datës 24.01.2020 të parashtruar nga Operatori Ekonomik "Rojet e Nderit" për aktivitetin: "Sigurimi i objekteve të Komunes së Prishtinës" dhe me numër të prokurimit: **616 -19-3238-211** nxjerr:

VENDIM

1. **Refuzohet** kërkesa për ri-shqyrtim e Operatori Ekonomik "Rojet e Nderit SHPK" e datës 24.01.2020 lidhur me aktivitetin e prokurimit "Sigurimi i objekteve të Komunes së Prishtinës" dhe me numër të prokurimit: **616 -19-3238-211** kundër *Njoftimit për Vendimin e Autoritetit Kontraktues* të datës 20.01.2020, të publikuar në web-faqe të KRPP-së.
2. **Vërtetohet Njoftimi i Autoritetit Kontraktues** i publikuar me datë: 20.01.2020;
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdojë respektimin e Vendimit të datës 20.01.2020
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

Arsyetim

Operatori Ekonomik "Rojet e Nderit SHPK" me datë 24.01.2020 ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Sigurimi i objekteve të Komunes së Prishtinës" dhe me numër të prokurimit: **616 -19-3238-211**.

Autoriteti Kontraktues, me datë 27.01.2020, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë dhe ka konstatuar si vijon:

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës janë plotësisht të pa bazuara për arsyet në vijim:

-Pretendimet që kanë të bëjnë me plotësimin e kërkesave të Dosjes së tenderit janë të pa bazuara për faktin se rivlerësimi është bërë duke respektuar të gjitha rekomandimet e Vendimit të OSHP-së, sipas të cilit AK në vlerësimet paraprake ka kryer vlerësimin në kundërshtim me nenin 59 të LPP-ik duke marrë për bazë kritere jo të matshme. Kriteret jo të matshme sipas Vendimit të OSHP-së dhe konstatimeve të ekspertit kanë qenë numri i orëve të

nates dhe numri i punetoreve dhe per te respektuar rekomandimet e tyre ne rivleresim jane marre parasysh vetem kriteret ligjore qe jane te matshme:pushimi vjetor dhe festat shteterore. -Pretendimi lidhur me kinse "pergenjeshtrimin" e AK-se lidhur me OE-ik te propozuar per dhenje te kontrates ju sqarojme se ne Vendimin e OSHP-se ka shenuar si vijon"... atehere nuk mund te deshmohet se ky grup i OE-ik ka ofruar deshmi te mjaftueshme se ka kontrata te implementuara ne vlere minimale prej 3.000,000.00 euro,pa bere sqarime shtese ne veçanti rreth vleres se kontratave te realizuara nga anetaret e konzorciumit "Aulona-Pol-1 SHPK dhe "Comando SHPK",ne tri vitet e fundit."Pikerisht bazuar ne kete jane kerkuar sqarime nga ky Grup i OE-ik dhe i njeiti ka ofruar deshmi te mjaftueshme e te cilat jane paraqitur edhe ne Raportin e Rivleresimit.

-Pretendimi tjetër se ne vleresim nuk jane marre per baze te gjitha bonuset dhe kostot sipas Ligjit te Punes eshte i nderlidhur me pretendimin e pare,por e sqarojme edhe njehere:nga te gjitha kostot qe parashihen me dispozita ligjore,sipas Vendimit te OSHP-se jane te matshme vetem ato kriteret qe i kemi kalkuluar ne llogaritjen e çmimit per ore pune ne Raportin e vleresimit dhe natyrisht nuk jane perfshire kriteret qe sipas te njejtut Vendim jane te pa matshme.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne sqarimet e paraqitura më lartë dhe në sqarimet e dhena ne Raportin e rivleresimit vendosi si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së.

Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.


Zyrtari përgjegjës i Prokurimit